PROÇEDURAT E ZGJEDHJES

Kryetari i bashkisë zgjidhet sipas dispozitave të kodit zgjedhor dhe ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" .

Çdo bashki ka kryetarin e saj, të zgjedhur sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor.

Kryetari i bashkisë mund të zgjidhet dhe të ushtrojë vetëm 3 mandate të njëpasnjëshme në kryetë bashkisë, me të drejtë rizgjedhjeje.

Mandati i kryetarit të bashkisë

Mandati i kryetarit të bashkisë vërtetohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, (dhoma civile) në juridiksionin e së cilës përfshihet bashkia përkatëse, brenda 20 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjes së tij.

Shpallja e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë bëhet në mbledhjen më të parë të këshillit bashkiak përkatës, ku kryetari bën betimin, sipas formulës së përcaktuar në nenin 50, të këtij ligji, dhe e nënshkruan atë.

Ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë fillon në çastin kur bën betimin dhe përfundon kur bën betimin kryetari pasardhës.

Kryetari i bashkisë është organi më i lartë i bashkisë dhe ushtron detyrat e funksionete përcaktuara në Kushtetutë,Ligjin e Vetëqeverisjes Vendore, e të tjera dispozita ligjore.